

Rekomandime për Propozim-Strategjinë Kombëtare të TIK-ut 2021-2025 dhe Planin aksional shoqëruar në lidhje me mundësinë e përdorimit nga ana e personave me aftësi të kufizuara

Në periudhën nga 1 korriku deri më 12 korrik 2021, një analizë e detajuar e aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara u krye në zbatimin e strategjive të përfshira në Propozim-Strategjinë Kombëtare për TIK 2021-2025 dhe Propozim-Planin Aksional të Strategjisë Kombëtare për TIK 2021-2025 nga një person me aftësi të kufizuara fizike. Analiza zgjati 8 ditë pune, me ç'rast u përfshinë të gjitha elementet e përfshira në Propozim-Strategjinë Kombëtare për TIK 2021-2025 dhe Propozim-Planin Aksional të Strategjisë Kombëtare për TIK 2021-2025.

Analiza përfshiu disa lloje të aftësive të kufizuara të pranishme në popullatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë personat me dëgjim të dëmtuar pjesërisht ose plotësisht, personat me shikim të dëmtuar pjesërisht ose plotësisht dhe personat me aftësi të kufizuara fizike ose mendore.

Gjatë analizës, u ngritën disa pyetje dhe vërejtje në lidhje me nevojat dhe mundësitë e njerëzve me aftësi të kufizuara dhe adresimin e nevojave të tyre specifike.

Në pjesën e "Forcimit të programeve mësimore të TIK -ut në sistemin arsimor", Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) pohon se do t'i drejtojë përpjekjet e saj për zhvillimin e ngjarjeve të TIK-ut dhe panireve për orientim në karrierë në mënyrë që të tërheqë sa më shumë studentë në sektorin e TIK-ut. Mirëpo, këtu lind **pyetja** a i merr qeveria parasysh personat me aftësi të kufizuara në përpjekjen për të tërhequr studentë në sektorin e TIK-ut?

Nëse marrim parasysh sistemin aktual të arsimit digjital në sektorin e TIK-ut, mund të thuhet se ai nuk është i arritshëm sa duhet për shumicën e njerëzve me aftësi të kufizuara dhe është një lloj diskriminimi sepse i privon këta njerëz nga mundësia për përparim dhe digjitalizim, veçanërisht në këtë sektor.

Për të arritur qëllimin e Qeverisë së RMV-së dhe për të përfshirë personat me aftësi të kufizuara në strategjinë për tërheqjen e më shumë studentëve në sektorin e TIK-ut, është e nevojshme të bëhen ndryshime thelbësore në digjitalizimin e sistemit arsimor që njerëzit me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar të jenë në gjendje të kenë qasje të pavarur në të gjitha mjetet digjitale, pavarësisht nga nevojat e tyre specifike.

Në këtë drejtim, nisma "për të siguruar qasje të lehtë në shërbime për të gjitha kategoritë e përdoruesve, duke përfshirë të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe verifikimin e vazhdueshëm të përputhshmërisë së dizajnit të ueb-faqes publike me udhëzimet dhe teknologjitë adaptive të [Iniciativës për qasje në ueb](#) " është në drejtim të mirë. Rrjedhimisht, rekomandohet rishikimi i ueb-faqeve ekzistuese të institucioneve shtetërore dhe e-shërbimeve/mjeteve digjitale që ato i ofrojnë në të gjitha fushat, si dhe përshtatja e tyre me nevojat e personave me aftësi të kufizuara për t'u mundësuar atyre pjesëmarrje në mënyrë aktive dhe të informuar në proceset shoqërore.

Çështja e përmendur më parë nuk u shpjegua fare në asnjë aspekt të digjitalizimit arsimor për personat me aftësi të kufizuara në Propozim-Strategjinë Kombëtare për TIK 2021-2025 dhe Propozim-Planin Aksional të Strategjisë Kombëtare për TIK 2021-2025.



Pyetja tjetër që u hap gjatë analizës kishte për qëllim ADMV-në ose "Agjencinë Digjitale të Maqedonisë së Veriut". Qeveria e RMV njofton se do të krijojë, përmes një procedure zyrtare ligjore, një Agjenci Qendrore Digjitale, e cila do të jetë një mundësi e re për krijimin e vendeve të reja të punës.

Nëse agjencia formon një ekip shumë të kualifikuar nga sektori privat dhe publik dhe ofron një mjedis dhe përvojë moderne, tërheqëse të punës, pyetja është nëse ajo do të përshtatet dhe do të vihet në dispozicion për personat me aftësi të kufizuara, të cilët do të ishin të kualifikuar për një pozicion të caktuar në ADMV.

Gjatë analizës, u vu re se Propozimi nuk thekson mundësinë e zbatimit të gjithëpërfshirjes në vendin e punës ku njerëzit me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar do të kishin të njëjtat mundësi për avancim dhe punë të pavarur si edhe bashkëpunëtorët e tyre.

Pas kryerjes së kësaj analize, u përcaktua se nevojat e personave me aftësi të kufizuara nuk janë mbuluar sa duhet në Propozim-Strategjinë Kombëtare për TIK 2021-2025 dhe në Propozim-Planin Aksional të Strategjisë Kombëtare për TIK 2021-2025 të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo çon në diskriminim dhe ndarje sistematike dhe bie ndesh me parimet dhe synimet reciproke të Qeverisë së RMV-së.